



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivery	08.06.2021	viti god year	1
Organ /Njësia Organ./Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHACK	2957/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 448/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën A.nr.448/2021 të datës 26.05.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga: "Shaban Manaj" Banesa Swiss LB, Kati III, Nr.18, Komuna e Istogut, kundër organit të punësimit Komuna e Istogut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 448/2021 të datës 26.05.2021, e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Komuna e Istogut me datë 25.02.2021 shpall konkursin me 05.Nr.71/21 për vendin e punës Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "Ndre Mjeda" Rakosh, në të cilin konkurse ka aplikuar edhe ankuesi Ankuesi Ismet Demaj, i pa kënaqur me mos përfshirjen e tij në procedurën e rekrutimit për Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "Ndre Mjeda" Rakosh, me datë 21.04.2021 parashtron ankesën me numër 05-016-13984 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Istogut.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Istogut me datë 06.05.2021 merr Aktvendimin me 05.Nr.192/21 me të cilin aktvendim ankuesit i refuzohet ankesa si e pa bazuar kështu që duke e udhëzuar palën për parashtrim të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Ankuesi me datë 24.05.2021 nëpërmjet Postës së Kosovës parashtron ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 26.05.2021 me numër të protokollit 2629/2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 26.05.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimi i datës 06.05.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Istogut; Konkursi i datës 25.02.2021; Kërkesa për punësim e kandidatit Përgjigja në kërkesë e datës 16.04.2021; Ankesa e ankuesit e datës 21.04.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Istogut; Vendimi për emërim të Drejtorit i datës 27.04.2021; Certifikata e lindjes e ankuesit; Certifikata që nuk është nën hetime; Certifikata shëndetësore; Deklarata nën betim Formulari I; Diploma e datës 10.06.2013 Kolegji i Biznesit; Diploma e datës 10.12.2012; Vërtetimi i datës 23.03.2021 nga OJQ "Folklori i Podgurit"; Raporti i punës për muajin maj 01-31.05.2018; CV Referenca e datës 26.07.2016; Certifikata e Regjistrimit të OJQ-së; Certifikata e numrit fiskal e datës 23.02.2015; Vërtetim i datës 17.08.2017; Referencë e datës 19.09.2018; Vërtetim i datës 29.06.2015; Vërtetim i datës 14.04.2017; Vërtetim i datës 19.09.2018; Referencë e punës e datës 19.09.2018; Referencë e datës 19.09.2018; Certifikata e USAID; Certifikata ATRC; Certifikata CBC; Certifikata ZANA; Certifikata Mehmet Akif; Mirënjohje e datës 07.03.2008; Certifikata e datës 20.12.2000; Dëftesa e datës 11.03.2002; Certifikata maj 2009.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka aplikuar në konkursin me 05.Nr.71/21 të datës 25.02.2021 të shpallur nga Komuna e Istogut për vendin e punës „Drejtor“ në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë "Ndre Mjeda"-Rakosh, andaj bazuar në dispozitat ligjore të nenit 2 paragrafit 4 Ligjit Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"*, respektivisht në këtë kuptim, Kolegji ka konstatuar se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike në fushën e arsimit, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesi tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve të *Shërbimit Publik*, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për shqyrtimin e ankesës vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.448/2021 të datës 26.05.2021, të parashtruar nga ankuesi



Pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”*.

Kështu qe, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr. 448/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Istogut;
- Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Istogut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Istogut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

